



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr.2324 Prot

Shkodër, më 13.02.2019

PËRGJIGJE TUAJËS ME NR 626 DATË 07.02.2019

Në vijim të shkresës Tuaj me lëndë “ Informacion për zbatim“ me nr.626 prot., datë 07.02.2019 sqarojmë si më poshtë:

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, Vendimit Nr. 319, datë 12.4.2017 ”Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave” neni 28, te ligjit nr 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Siç jeni në dijeni, Bashkia Shkodër ka fituar projektin “**Jeto me Sportin**”, projekt në standart që përfshin “Rikualifikim i terreneve sportive” në disa shkolla përfshi dhe shkollën ” At Gjon Karma”, Njësia Administrative Gur i Zi.

Bashkia Shkodër ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore për objektin “**Jeto me Sportin**”, konform standardeve teknike të kërkuara dhe të miratuara nga ministria. Në tabelen informuese të objektit janë të afishuara të dhënat e detyrueshme, të cilat ju pretendoni në shkresën tuaj.

- Vendimin e lejës së ndërtimit ju kemi përcjellë me shkresën nr . 2081 prot., datë 08.02.2019

I gjithë informacioni i kërkuar nga ana e Juaj është i afishuar në faqen e Agjensisë së Prokurimeve Publike <http://app.gov.al> dhe Qendra Kombëtare e Biznesit <http://qkb.gov.al> dhe faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

Meqenëse, jeni një nga shkollat e përzgjedhura për implementimin e këtij projekti, kërkojmë bashkëpunimin nga ana juaj.

Faleminderit për mirëkuptimin.

KRYETAR

Voltana ADEMI

